



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura e III-të

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja e parë, dt.13.02.2008
Salla nr. N.225 ora 14,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Memli Krasniqi, Vlora Çitaku, Adem Hajdaraj, Fatmire Berisha, Arsim Rexhepi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Mark Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri, Drita Morina në cilësinë e zyrtareve ligjore dhe Mirjeta Heta asistente administrative.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Mbledhja konstituive e Komisionit.
2. Të ndryshme.

1. Mbledhja konstituive e Komisionit.

Kryetari i Komisionit **Agim Veliu**, në fillim tha se kjo mbledhje ka më tepër karakter njohës me anëtarët e Komisionit si dhe me natyrën e punës së Komisionit.

Më pas propozoi që Komisioni do duhej ta hartoi një plan pune në bazë të të cilit do të punojë. Plani i punës së Komisionit duhet të jetë në përputhje me programin e punës së Qeverisë, ndërsa për punën dhe kohën e mbajtjes së mbledhjeve do të vendosim bashkarisht.

Adem Hajdaraj, tha se me konstituimin e Komisionit do duhej të kordinohemi për orarin e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta, si dhe të përcaktohem lidhur me planin e punës. Nga përbërja e këtij Komisioni shpreson se do të kotribuohet në këto fusha të veprimtarisë.

Mark Krasniqi uroi përbërjen e re të Komisionit, ndërsa sa i përket orarit të punës kjo do të caktohet me plan të punës në bashkëpunim me anëtarët e Komisionit që do të varet nga vetë dinamika e punës.

Vlora Çitaku tha se do duhej të përcaktohem i për kohën e mbajtjes së mbledhjeve të Komisionit si dhe të hartohet një plan i punës.

Puna e Komisionit varet nga dinamika e Qeverisë, ne si Komision do duhej të jemi aktiv si në aspektin e amendamentimit, hartimit dhe inicimit të projektligjeve ashtu edhe në përcjelljen e punës së Ministrive që i mbulon Komisioni. Të bëhen vizita në institucionet me qëllim të njohjes së përafërt me të vështirësitë dhe të rehat në institucionet arsimore.

Memli Krasniqi ishte gjithashtu i mendimit që të vazhdohet me përvojën e këtij Komisioni si dhe të hartohet një plan i punës për ditët në vijim.

Si çështje me rëndësi për këtë Komision është bashkëpunimi me ministrinë përkatëse, dhe aspektet në fushëveprimtari të Komisionit.

Arsim Rexhepi në diskutimin e tij shtroi çështjen e mësimdhënësve të cilët aktualisht disa muaj nuk kanë marrë paga, njëherit kërkoi nga kryetari i Komisionit që kjo çështje të inicohet në njerën nga mbledhjet e ardhshme.

Enis Kervan propozoi që mbledhjet e Komisionit të mbahen çdo javë pasi që fushëveprimtaria e Komisionit është mjaft e gjërë si dhe të organizohen edhe vizita në terren.

Drita Kadriu tha se çështje me rëndësi për këtë Komision është plani i punës që do të ndihmonte në organizimin dhe punën e Komisionit.

2. Të ndryshme

Mbledhja e ardhshme e Komisionit do të caktohet javën e ardhshme

Mbledhja përfundoi në orën 14,30

Kryetari i Komisionit,
Agim Veliu